



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivery	30.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOR	3830	2022	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.466/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.466/2022 të datës 19.05.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatir kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike “ harmonizim i koeficientit të pagës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 30.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.466/2022 e datës 19.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Kamenicës, me datë 19.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2914/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Kryetarit të Komunës së Kamenicës lidhur me kërkesën për harmonizim të koeficientit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës, ndërsa kjo e fundit më datë 03.06.2022 ka përcjell në Këshill përgjigjen me numër protokolli 3239/2022 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2914/2022 të datës 19.05.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3041 të datës 25.05.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3239/2022 të datës 03.06.2022; Akt-in e emërimit me numër 12371 të datës 20.04.2015; Kërkesën për avancim me numër 10/01 të datës 07.02.2013; Kërkesën me numër 4219 të datës 07.02.2014; Kërkesën me numër 108813 të datës 15.04.2019 për transferim në punë dhe detyra tjera; Kërkesën me numër 19233 të datës 12.07.2021 për pagesën e ndryshimeve në pagë; Vendimin me numër 11247 të datës 19.04.2019; Kërkesën me numër 5782 të datës 02.03.2022 pre harmonizimin e koeficientit me pozitën e punës zyrtar për sport; Kërkesën me numër 4219 të datës 07.02.2014; Vendimin e datës 18.04.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 20.12.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional të datës 01.02.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës konkretisht Akt-it të emërimit me numër 12371 të datës 20.04.2015, rezulton së ankuesi *ka qenë i sistemuar në pozitën "Mirëmbajtës i shtëpisë së Kulturës"*, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në fshatin Roganë, me koeficient pesë (5) të pagës. Kryetari i Komunës së Kamenicës me Vendimin me numër protokollit 02/11247 të datës 19.04.2019, përmes transferimit të përhershëm ka bërë sistemimin e ankuesit në pozitën e punës *"Zyrtar për Sport"* pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke përcaktuar së transferimi behët më pagë të njëjtë deri në hyrjen në fuqi të katalogut të vendeve të punës ku dhe me pastaj do të ndryshohet edhe akt emërimit i ankuesit.

Me tej nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi më datë 12.07.2021, datë 02.03.2022 dhe datë 19.04.2022 ka parashtruar kërkesë të Kryetari i Komunës së Kamenicës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës për pozitën e *"Zyrtar për Sport"*.

Pas heshtjes së Kryetarit të Komunës lidhur më kërkesat e ankuesit si më lartë, i njëjti më datë 19.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, duke propozuar që Këshilli të detyroj Kryetarin e Komunës së Kamenicës që të aprovoj kërkesën për harmonizimin e koeficientit në pagesë me pozitën e *"Zyrtarit të Sportit"* duke bërë edhe kompensimin e pagës dhe fitimit të humbur me kamatë vjetore prej 8% që nga data e avancimit në pozitën *"Zyrtar për Sport"* respektivisht nga data 19.04.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka konstatuar se në kohën e transferimit të përhershëm të ankuesit me Vendimin me numër protokollit 02/11247 të datës 19.04.2019, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë nenin 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për*

Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se *nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës*". Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë se ankuesi në rast të pakënaqësisë me Vendimin me numër protokolli 02/11247 të datës 19.04.2019 sipas të cilit ankuesit nuk i është njohur koeficienti i pagës për pozitën e transferuar, i njëjti ka mundur të ushtroj ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, andaj, meqenëse ankuesi deri me datë 12.07.2021 nuk ka ndër marr asnjë veprim juridik kundërshtues kundër Vendimit për transferim të përhershëm në pozitën Zyrtar i Sportit, Kolegji konstaton së ankesa e ankuesit A.nr.466/2022 e datës 19.05.2022 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Nisur si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.466/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

